



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kms hc.al



www.kms hc.al

15 Prill 2025

NJOFTIM

PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES NË SUBJEKT TË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NËPUNËSIN CIVIL GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE

Në funksion të realizimit të procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil gjatë periudhës zgjedhore dhe në zbatim të Urdhrit nr. 35 (nr. 46/1 prot.), datë 15.04.2025, Komisioneri ka planifikuar kryerjen e verifikimeve të drejtpërdrejta në terren në 59 subjekte, me qëllim kontrollin e situatës faktike dhe garantimin e respektimit të parimeve të shërbimit civil.

Monitorimi në subjekt do të fokusohet në verifikimin e të dhënave të raportuara nga Grupet e Monitorimit, si dhe për të evidentuar dhe adresuar probleme që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, kryesisht lidhur me disa çështje si:

- Emërimet e reja në punë, në pozicione të shërbimit civil.
- Pezullimet në shërbimin civil, për arsye të ndryshme.
- Dorëheqjet nga shërbimi civil.
- Largimet nga shërbimi civil, si nëpërmjet aplikimit të masës disiplinore, ashtu edhe për shkak të dy vlerësimeve negative.
- Masat disiplinore të llojeve të ndryshme, nëse ka pasur në këtë periudhë.
- Nëpunësit civilë të emëruar në organet zgjedhore, që janë: KZAZ, KQV, GNV dhe aktet e miratimit nga ana e institucionit për këtë veprimtari.
- Nëpunësit civilë që kandidojnë për deputetë, shoqëruar me aktet e pezullimit të tyre nga detyra, miratuar nga institucioni.
- Denoncimet në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me parregullsi në drejtim të zbatimit të ligjit, në lidhje me pjesëmarrjen në fushatë elektorale.
- Kallëzimet penale, nëse evidentohen për nëpunës civilë në institucionin përkatës, apo të masave të sigurisë që janë marrë për nëpunësit civilë nga prokuroria apo gjykata.
- Probleme të ndryshme që i kanë dalë gjatë procesit të monitorimit, Grupit të Monitorimit.